



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Emërtimi i organit të komunës/Naziv opstinskog organa/ Name of the municipality structure

Komiteti konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë
Datë: 13.12.2024

		REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA	
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY: KAMENICA		CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA	
Sh. U.	01	Nr. Br.	38744
Nr. i faq.	3	Data:	20/12
Br. str.		Datum:	2024
KAMENICËJA			

PROCESVERBAL

Anëtarët e komitetit konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë që morën pjesë në këtë takim janë:
Basri Januzi – nga komuniteti i biznesit;
Fatmir Krasniqi - nga komuniteti i biznesit;
Ibadete Sadiku - nga komuniteti i biznesit;
Kadrije Mustafa - nga komuniteti i biznesit;
Lavdim Klaiqi – nga shoqëria civile;
Labinot Skoverqani – nga kuvendi komunal;
Rina Krasniqi Kryeziu – nga kuvendi komunal;
Albana Ajvazi – nga kuvendi komunal.

Në këtë takim nuk ishte prezent një anëtarë nga kuvendi komunal Valentina Kastrati Kryeziu.

Këtë takim të katërt të këtij komiteti e organizoi Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë.

Temat e diskutimit të këtij takimi ishin:

1. Plani buxhetor, plani vjetor i investimeve kapitale dhe progresi në realizimin e strategjisë zhvillimore;
2. Tarifat dhe taksat administrative dhe komunale, në fazën e planifikimit;
3. Dokumentacioni i planifikimit hapësinor (planet urbanistike lidhur me zonat afariste/industriale).

Takimin e hapi Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë Burbuqe Leka, ku i përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit dhe i ftoi anëtarët e këtij komiteti të diskutojnë rreth pikave të cilat do i trajtoj ky komitet. Drejtoresha i prezantoi të gjitha pikat e diskutimit, dhe u aprovua nga anëtarët e komitetit rendi i ditës së këtij takimi.

Drejtoresha e D.E.ZH.D. prezantoi planin e buxheti për vitin 2025 ku është paraparë si investime kapitale tri projekte:

- Ndërtimi apo adaptimi i objekteve komunale në bujtina malore;
- Ndërtimi i tregut të gjelbër;
- Blerja e tezgave mobile për promovimin e produkteve.

Gjithashtu është prezantuar edhe planifikimi i subvencioneve për mbështetje të bizneseve të vogla dhe të mesme për vitin 2025 në shumën prej 170,000.00 euro.

Basri Januzi : Falënderoi drejtoreshën për prezantimin e buxhetit të drejtorisë dhe propozoj që të funksionalizohet Parku i Biznesit si dhe të futet në planifikimin e buxhetit për vitet e ardhshme ashtu siç është planifikuar lokacioni sepse është vend i përshtatshëm për çdo biznes.

Gjithashtu propozoi për piken e dytë të rendit të ditës që taksat komunale të hiqen sepse si anëtar që vjen nga komuniteti i bizneseve mendoj që mjaftueshëm paguajnë tatime për shtetin dhe mos të ketë edhe taksa komunale.

Fatmir Krasniqi: Falënderit drejtoreshës për prezantimin e planit të buxhetit të drejtorisë dhe për punën që është duke e bërë.

Sa i përket subvencioneve mendoj që bizneset të subvencionohen me shumën më të madhë që të shihet ndihma që po ju bën komuna sepse me shumën të vogël nuk mendoj që keni arritur ta ndihmoni biznesin mjaftueshëm.

Gjithashtu sa i përket pikës së dytë të taksave dhe tarifave nësi komuniteti i bizneseve mendoj që paguajnë mjaftueshëm taksa dhe tarifa dhe njëjtë si parafolësi mendoj që duhet të hiqen këto taksa dhe tarifa komunale sepse janë ngarkesë e madhe për biznesin, si dhe të ketë kujdesë gjatë dhënies së granteve apo subvencioneve komunale që të përfitojnë bizneset që i paguajnë të gjitha taksat dhe jo bizneset që kurrë nuk paguajnë asnjë taksë të shtetit.

Propozim tjetër për pikën 3 të këtij rendi të ditës është lehtësimi i procedurave administrative gjegjësisht në urbanizëm për leje, si dhe të mirën propozimet nga qytetarët për planin zhvillimor komunal pasi që është në fazën e hartimit të këtij PZHK.

Burbuqe Leka: Sa i përket Parkut të Biznesit nësi dhe asamblistët që janë të pranishëm do ta përcjellim si propozim të kryetarit të komunës dhe të kuvendi komunal, gjithashtu do të shkoj në kuvend ky procesverbal i këtij takimi dhe do të diskutojmë në lidhje me taksat dhe tarifën edhe në kuvendin komunal dhe kryetarin e komunës.

Kurse të grantet apo subvencionet e bizneseve është kriter që nuk mund të aplikoj apo nuk do të shqyrtohet aplikacioni i biznesit që ka obligime ndaj komunës apo shtetit, është kriter që duhet të sjellin si dëshmi që nuk kanë obligime bizneset për të shqyrtuar pastaj si aplikacion.

Pika tjetër që propozoi z. Fatmir Krasniqi për lehtësirat në urbanizëm dhe PZHK-në, nësi drejtori çdo biznesit që kanë kërkuar pronë në drejtorinë tonë për investime dhe që nuk kanë qenë të parapara në PZHK-në e kaluar, gjatë kësaj faze që gjendet PZHK i kemi njoftuar të gjitha bizneset që të paraqiten në komunë dhe të adresojnë kërkesat e tyre për ndërrim të destinimit të pronës në urbanizëm që të mirën pastaj kërkesat për pronë dhe të shqyrtohen nga ne, sepse kanë mbetë si kërkesa pa u shqyrtuar sepse nuk kanë qenë të njëjta destinimet e pronave me PZHK-në e kaluar me atë çfarë kanë kërkuar.

Lavdim Klaiqi: Me vjen mirë që ka filluar të bëhet diçka për turizëm sepse ka qenë kërkesë edhe në takimet e tjera të këtij komiteti që Kamenica është vend i përshtatshëm për të zhvilluar turizmin dhe jemi duke humbur shumë në këtë drejtim përderisa nuk ndërmarrim asgjë, dhe me vjen mirë që nëqoftesë nga

ky komitet është marre ky propozim atëherë po e tregon komuna seriozitetin që ka krijuar këtë komitet për zhvillim ekonomik.

Rina Krasniqi: Unë që vij nga kuvendi me këto kërkesa që i paraqitet sot në këtë takim, unë do të flas me grupin parlamentar nga cili subjekt politik që unë i përkas dhe do të jemi dakord për krejt propozimet që i paraqitet që ti mbështesim edhe në kuvend.


Albana Ajvazi: Gjithashtu edhe unë njëjtë si Rina do të veproj dhe mendoj që do ta keni mbështetjen nga ne.

Burbuqe Leka: Unë ju falënderoj për këtë pjesëmarrje dhe për të gjitha propozimet dhe shqetësimet që ju i paraqitet në këtë takim, mendoj që bashkërisht me kryetarin e komunës dhe kuvendin komunal do të shqyrtojmë këto kërkesa.

Nëqoftese keni edhe ndonjë gjë tjetër që dëshironi për ta shtuar, atëherë mund ta merrni fjalën.

Pasi që nuk keni më asgjë për të shtuar, unë po e mbyll sot këtë takim duke ju uruar festat e fund vitit dhe që ta keni një vit tjetër me të suksesshëm.

Procesmbajtës: Valdete Sopi



Datë: 13.12.2024